



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOCATES BAR ASSOCIATION  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

**V.KA.nr.8-8/20**

**KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS**, në Kolegjin e përbërë prej av.Kadri Sylaj – Kryetar i Kolegjit, av.Edona Sina dhe av.Ruzhdi Berisha – anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në Zyren Disiplinore të OAK-së, duke vendosur sipas ankesës nr.8-5/2020 të datës 13.04.2021 e parashtruar nga avokati O. L. me seli të zyrës në P., kundër vendimit të Komisionit Disiplinor V.KD.nr.8-4/2020 të datës 17.03.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Aprovohet pjesërisht**, ankesa nr.8-5/2020 e datës 13.04.2021 e ushtruar nga avokati O. L. me seli të zyrës në P., **NDRYSHOHET** vendimi i Komisionit Disiplinor V.KD.nr.8-4/2020 i datës 17.03.2021, sa i përket lartësisë së dënimit, ashtu që për shkeljen disiplinore për të cilën është shpallur përgjegjës i shqiptohet gjoba në lartësi prej 500 E (pesëqind euro).

### **A r s y e t i m**

Komisioni Disiplinor i OAK-së me vendimin V.KD.8-4/2020 të datës 17.03.2021 ka shpallur përgjegjës të paraqiturin av.O. L. sepse në cilësinë e avokatit ka pranuar që ti ofrojë ndihmë juridike palës së cilës ka qenë i detyruar ta refuzojë sipas dispozitave ligjore në fuqi ku thuhet: se avokati është i detyruar t'ia refuzojë palës ndihmën juridike nëse në qështjen e njejtë apo në qështjen që ka lidhje juridike me të parën ka punuar si avokat dhe i cili ka përfaqësuar palën kundërshtare. I njejtë ka përpiluar shkresë për palën kundërshtare duke ia përpiluar parashtrësën për ndërhyrje palës kundërshtare. Me çka ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 par.1, nënpar. 1.3 i Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 25 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Andaj, është shqiptuar gjoba në shumë prej 800.00€ (tetëqind euro), si dhe është obliguar që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumë prej 50.00€ (pesëdhjetë euro).

Kundër këtij vendimi i paraqituri ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor, ankesën e ka deponuar në postë me datë 08.04.2021, e njejtë është protokoluar me datë 13.04.2021 në Zyren Disiplinore të OAK-së. Ankesa ka atakuar vetëm lartësinë e gjobës, duke kërkuar zbutje të gjobës së caktuar nën minimumin e paraparë me nenin 123 par.3 të Statutit të OAK-së, me arsyetimit se tani e ka moshën 66 vjeqare – pensionist dhe ka probleme shëndetësore.

Komisioni i Ankesave i OAK-së- Kolegji shqyrtues , si organ i shkallës së dytë, pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve në ankesë kundër vendimit të atakuar, në mbështetje të nenit 110 par.1 dhe par.2 të Statutit të OAK-së, si dhe nenit 46 par.1 pika 1.3 dhe nenit 52 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, ka gjetur se:

***Ankesa e të paraqiturit është pjesërisht e bazuar.***

Sipas nenit 123 par.3 të Statutit të OAK-së, për shkeljet e rënda minimumi i gjobës mund të jetë 500€ (pesëqind euro), ndërsa sipas nenin 123 par.2 i Statutit të OAK-së përcaktohet se lartësia e gjobës mund të jetë deri në 5.000€ (pesëmijë euro).

Komisioni i Ankesave-Kolegji shqyrtues analizoi dhe mori për bazë të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit dhe vlerësoi se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht vetëm sa i përket lartësisë së gjobës duke pas parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar shkeljen disiplinore si dhe faktin se ndaj të paraqiturit më parë nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

Andaj mbështetur në arsyet e lartcekura, Komisioni i Ankesave gjeti se të paraqiturit Av. Osman Lajçi pjesërisht duhet ti aprovohet ankesa, ashtu që sipas nenit 110 par.1 dhe par.2 të Statutit të OAK-së, si dhe në bazë të nenit 46 par.1 pika 1.3 dhe nenit 52 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, vendosi sikur në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS  
PRISHTINË, KA.nr. 8-8/2020, datë 05.05.2021**

**Kryetari i Kolegjit  
Avokat Kadri Sylaj**